

Përmbajtja

Hyrje	05
SEKSIONI I	
Ankesa me objekt "cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit"	07
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "cenimin e të drejtave të fëmijëve"	33
SEKSIONI III	
Ankesa jashtë juridiksionit	41
SEKSIONI IV	
Ankesa jashtë afatit	48
SEKSIONI V	
Komunikime tregtare	55
SEKSIONI VI	
Të ndryshme	57

Hyrje

Në mjedisin kompleks të komunikimit bashkëkohor, media audiovizive mbetet një forcë mendikim të jashtëzakonshëm, jo vetëm në formësimin e opinionit publik por edhe në mbrojtjen e vlerave thelbësore të shoqërisë.

Një fakt domethenës është se pjesa më e madhe e ankesave që i drejtohen Autoritetit të Mediave Audiovizive të reflektura në buletin nr.17 të Këshillit të Ankesave, lidhen me cënimin e të drejtave të fëmijëve, duke dëshmuar një ndërgjegjësim në rritje për mbrojtjen e kësaj shtrese delikate.

Kjo vëmendje e shtuar konfirmon jo vetem ndjeshmerine sociale ndaj femijeve si individë vulnerabël por edhe pritshmërite e larta ndaj mediave, për të respektuar standartet më të larta, etike dhe profesionale.

Në këtë kontekst, rritja e besueshmërisë së publikut tek autoritetet rregullatore mbetet një domosdoshmëri dhe sfidë e vazhdueshme.

Si strukturë e pavarur pranë AMA-s, është inkurajuese të vërejmë vit pas viti, rritjen e numrit të individëve që i drejtohen Autoritetit si dëshmi e besueshmërisë dhe besimit të publikut në integritetin e institucionit.

Është për t'u nënvizuar fakti se nga 349 ankesa të adresuara në AMA gjatë vitit 2024, 72.5% e tyre u dërguan nga individë duke dëshmuar ndërgjegjësimin dhe besimin e qytetarëve në rolin e tij rregullator.

Sigurimi i një hapësire mediatike të mbrojtur nga përmbajtjet e dëmshme dhe promovimi i një diskursi të ndershëm janë element kyç në ndërtimin e një mjedisi informativ të shëndetshëm.

Edukimi i një publiku të ndërgjegjshëm në përzgjedhjen e përmbajtjeve audiovizive është thelbësor për një mjedis audioviziv të përgjegjshëm dhe cilësor.

Krahas parimit për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, ruajtja e dinjitetit njerëzor është një tjetër shtyllë themelore e misionit të AMA-s që udhëheq veprimtarinë e transmetimeve audiovizive si një angazhim thelbësor për të siguruar respektin për të drejtat e individëve dhe për të garantuar një mjedis të sigurt dhe etik.

Vlen të theksohet se mbrojtja e dinjitetit të viktimës përbën një tjetër dimension thelbësor të këtij buletini duke reflektuar detyrimin për një raportim mediatik të përgjegjshëm dhe

profesional ku respektimi i integritetit të individit mbetet një detyrim i patjetërsueshëm.

Këshilli i Ankesave dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive mbetet i palëkundur në zotimin e tij për të zbatuar me përpikmëri parimet e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit të AMA-s

duke garantuar një hapësirë mediatike të besueshme, të përgjegjshme dhe me integritet.

Ne besojmë se vetëm përmes këtij angazhimi të vazhdueshëm mund të forcojmë besueshmërinë, të mbrojmë të drejtat e publikut dhe të sigurojmë një media që pasqyron vlerat më të larta të shoqërisë.

1

Ankesa me objekt

"cenimin e rregullave

të etikës dhe dinjitetit"

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
AWA Albania	Top Channel	Reklama Lori-Caffe	18.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Koalicioni kundër seksizmit, AWA, AWEN, GADC i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në lidhje me një reklamë të Lori Caffesë me pretendimin se *"seksualizonte modelen, duke përdorur trupin e saj për të tërhequr vëmendjen për produktin e tyre, kafenë e ftohtë kanaçe"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi rastin dhe evidentoi se reklama e Lori Caffesë promovonte linjën e re të kafesë së ftohtë, e cila ilustruhej nga një modele e veshur me rroba banje, teksa përpiquej të thyente

një kub akulli brenda të cilit gjendej një kanaçe kapuçinoje.

Këshilli evidentoi se përmbajtja audiovizive e reklamës në fjalë ishte ideuar për të evidentuar risitë e produktit që reklamohej, siç ishte promovimi për herë të parë i linjës së ftohtë të kafesë Lori në një sezon të nxehtë veror.

Përfshirja e modeles me rroba banjo në reklamë dhe çdo element tjetër freskues i shërbente marrëdhënies me produktin dhe reklamimit të saj.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shmangie të Ligjit Nr. 97/ 2013 *"Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Urdhri i Psikologut	OSHMA & Portale	Lajm	03.07.2024

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësues të Urdhrit të Psikologut i kërkoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) marrjen e masave pas publikimit të një lajmi, me pretendimin se përmbante informacione të pavërteta. Lajmi ishte publikuar në disa media dhe portale, me titull "Presidentja e Urdhrit të Psikologut znj.Valbona Treska u shkarkua nga detyra, datë 27.01.2024".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës përkatëse, ankueses ju bë me dije se :

- Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 52, "Shqyrtimi i ankesave",

"Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë". Bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive ishte i datës 27.01.2024 dhe për rrjedhojë nuk mundej të ishte objekt shqyrtimi, pasi ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara.

- Sa i takon publikimit të lajmit në disa portale dhe platforma online, konkretisht (Pamflet, CNA HD, Bold News, Tpz.al, Gazeta Fjala, Dosja.al, Fax.al, Gazeta Tema, Gazeta Shqip Bota Sot, Gazeta Panorama dhe Syri.net), ankueses iu bë me dije se bazuar në nenin 2 "Fusha zbatimit", mediat online dhe portalet vijojnë të jenë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	RTSH	"Jetë shqiptare"	26.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i drejtoi një shkresë Këshillit të Ankesave me anë të së cilës përcillej ankesa e shtetases A.L. Në ankesë pretendohet se emisioni "Jetë Shqiptare" transmetuar në televizionin publik RTSH, po e përdorte tragjedinë e vetëvrasjes së vajzës së saj për qëllime mediatike. Sipas Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "Ankuesja ... i ishte drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH...për marrjen e masave emergjente për të urdhëruar fshirjen nga qarkullimi të përmbajtjes së emisionit "Jetë shqiptare", të datës 13 qershor 2024..., por ende nuk kishte vepruar asnjëri".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave bëri verifikimin e faktit

bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 97/2013 dhe me shkresën nr.1976/1prot., datë 1 korrik 2023, i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të RTSH-së, paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar, për të cilën, nuk mori përgjigje brenda afatit 7 ditor (ligji 97/2013, Neni 52 "Shqyrtimi i ankesave", pika 3).

Gjithashtu, Këshilli vërejti se OSHMA-ja nuk i ka përmbushur detyrimet, sipas pikës 6 dhe 7 të nenit 53 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër dhe bazuar në nenin 53, pika 14 të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s vendosjen e sanksionit gjobë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë sipas nenit 133, pika 6 të ligjit Nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e cila u miratua nga Bordi i AMA-s.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Redaksia Zëri	Link	-	14.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Redaksia "Zëri" i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s përmes së cilës kërkonin të denonconin, sipas tyre: *"një rast të paprecedentë të gjuhës seksiste që përfshinte regjisorin B.K"*.

Ankuesit pretendonin se:

- *"ky i fundit kishte deklaruar "se humori është vetëm për të mençurit, pra për burrat dhe se zonjat nuk janë të zonjat për këtë!"*
- *mos tërheqjen e zotit K., i cili edhe në telefonatat me ZËRI "i kishte qëndruar versionit të tij duke ripërsëritur dhe njëherë fyerjet"*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të saj, ankuesi u informua se, AMA në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator, në

fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në lidhje me materialin e publikuar, në linkun e referuar prej tij, ankuesit iu me bë me dije se sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit", si edhe ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, portalet, vijojnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Sa më sipër ankuesit ju kërkua të plotësonte elementët e ankesës për të vijuar trajtimin e mëtejshëm të saj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.D	TV Klan	"Stop"	18.06.2024

1. Objekti ankesës

Shtetasi E.K i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s në lidhje me emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" përmes së cilës pretendohet se:

- "... jam etiketuar si një mashtrues, përvetësues dhe shkatërrues i pronave të tjerëve.
- Drejtuesit e emisionit ...nuk kanë kërkuar një prononcim në lidhje me këto fakte tek unë,
- Jam vendosur si subjekt i trajtimit të një problematike e cila nuk ka asnjë fakt apo informacion të vërtetë,
- drejtuesit e emisionit ushtrojnë presion edhe mbi palët të cilët janë pjesë e procesit për të cilin kam investuar edhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë...,
- dhe se...në emisionin "Stop" të datës 16 Maj 2024, janë parashtruar një seri faktesh dhe rrethanash të pavërteta, që kanë lidhje me personin tim dhe që kanë cenuar nderin dhe personalitetin tim, e për të cilat kam

paraqitur një ankim penal, me objekt fyerjen, shpifjen e kryer nga autorët e emisionit".

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të emisionit "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", prej të cilit evidentoi se:

- Nga shqyrtimi i materialit filmik rezultoi që episodi i referuar ishte transmetuar në emisionin "Stop" në orën 20:23:00, si vijim i trajtimit të denoncimit të ardhur nga znj.

F.H në lidhje me një marrëveshje/kontratë pronësie, ku ndër të tjera përmendej edhe ankuesi.

- Nga përmbajtja audiovizive rezultoi se ndryshe prej pretendimeve të anksuesit, ai ishte pyetur nga gazetari i emisionit "Stop" lidhur me çështjen në fjalë, në përmbushje të detyrimeve të nenit 33, pika 1/b) "Parimet themelore", i ligjit nr.97/2013 i cili përcakton se: "... çështjet që janë tema të debatit

publik, duhet të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara”.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit investigativ dhe gazetarit janë pjesë e kompetencave editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e Ligjit Nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, sipas të

cilit *“veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë”* (neni 4, pika 1/a).

Nga shqyrtimi i ankesës por edhe të pretendimeve të formuluar prej tij në shkresat nr. 1884 dhe parashtesës nr.1884/1, dt.18-19.06.2024, ku ankuesi pretendonte për fyerje deri në shpifje të bërë nga drejtuesi dhe emisioni *“Stop”*, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit se shpifja nuk trajtohet nga dispozitat ligjore, tagër i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Vetëinim	RTSH	-	08.07.2024

1. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) konstatoi publikimin e një videoje ekskluzive të "përleshjes së Noizy-it dhe DJ Crax me Tik-Tok-erin enjohurtë Kosovës" në faqen zyrtare të shpërndarjes së videove të Radio Televizionit Shqiptar në rrjetet sociale Facebook, konkretisht (<https://www.facebook.com/RTShqiptar>) dhe Instagram <https://www.instagram.com/rtshqiptar/> dhe Tik Tok.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave gjykoi se pavarësisht përdorimit të teknikës së mbulimit të pamjeve të dhunës për të evituar efektin negativ që krijonte përmbajtja e papërshtatshme tek shikuesit, sidomos tek të miturit, publikimi i videos në fjalë ishte në cenim të rregullave të etikës "...", bazuar në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, për "moslejimin e

transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve", (pika 2/d), si dhe "moslejimin e transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën", (pika 2/dh).

Po ashtu neni 32, pika 4, përcakton se "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin urrejtjen dhe çdo formë tjetër diskriminimi".

Në nenin 33, thuhet mes të tjerave që, "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", (pika 1/ç); apo "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale", (pika 1/d).

Transmetuesit publik iu bë me dije se platforma e shpërndarjes së videove "YouTube", kompetencat, që ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023) i jep AMA-s si autoritet rregullator, prekin veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve.

Konkretisht, neni 2 i ligjit parashikon se objekt zbatimi i tij janë transmetimet audiovizive lineare (të transmetuara në kohe reale), transmetimet audiovizive jolineare (video-on-demand), shërbimet

mbështetëse të tyre, si dhe shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove.

Sa më sipër, Autoriteti i Mediave

Audiovizive kërkoi nga Transmetuesi Publik RTSH, heqjen e përmbajtjes audio nga kanali zyrtar i shpërndarjes së videove.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
P.H.	TV Klan	Stop	19.07.2024

1. Administrimi i Ankesës

Shtetasja P.H. i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me anë të së cilës shprehte shqetësimin se emisioni "Stop", transmetuar në TV Klan i kishte cenuar *"dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe cenimin e fshehtësisë së jetës private të individit"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit audioviziv, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa e shtetasës P.H ishte jashtë afateve

ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

- Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 52, "Shqyrtimi i ankesave", përcakton se : *"Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë"*,

Ankueses iu bë me dije se sipas kësaj dispozite ligjore ankesa e saj nuk mund të ishte objekt shqyrtimi nga institucioni ynë, pasi është jashtë afateve ligjore të parashikuara.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
V.M	Report TV	Pa Gjurmë	21.06.2024

1. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori një ankesë nga shtetasja V.M me anë të së cilës pretendohet se në emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në "Report TV" ishte transmetuar një intervistë nga babai i saj P. M, gjithashtu ish in publikuar foto dhe të dhëna personale të saj dhe të familjes.

Ankuesja pretendonte se kishte kontaktuar redaksinë e emisionit "Pa gjurmë", autoren dhe moderatoren si edhe Drejtoreshën e përgjithshme, por ishte përballur me shmangie të përgjegjësive, mbyllje të telefonit dhe moskthim përgjigje....

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-së "Report TV", paraqitjen e

pretendimeve lidhur me ankesën në fjalë.

Në përgjigjen e tyre, OSHMA-ja, bëri me dije se : *"ky emision ishte hequr nga kanali i YouTube i Report TV"*.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se përmbajtja audiovizive ishte hequr nga :

- *kanali zyrtar i shpërndarjes së videove, YouTube, të emisionit "Pa gjurmë" si dhe në faqen zyrtare të OSHMA-së.*

Përtej rastit, Këshilli i Ankesave e siguroi ankuesen se do të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet, që vijnë për shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60 datë 10.07.2023 si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre.

Ankesa e paraqitur nga: Subjekti audioviziv Programi Data

Observatori për të drejtat e Femijeve dhe të rinjve **Top Channel Digitalb**

Reklama Lori Caffè 08.08.2024

1. Administrimi i Ankesës

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave në lidhje me dy reklama të shfaqura në televizionin Top Channel, konkretisht reklama e kapuçinos "Lori Caffè" dhe reklama në lidhje me ofertat e "DigitAlb". Ankuesit pretendonin se promovonte "*modele vajzash të gabuara që rrezikojnë të ndiqen nga të miturat në vend*", ndaj kërkuan "*ndalimin dhe mos transmetimin e mëtejshëm të tyre...*".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi dy rastet në fjalë dhe evidentoi se:

- Reklama e Lori Caffè-së promovonte linjën e re të kafesë së ftohtë, e cila ilustruhej nga një modele e -veshur me rroba banje teksa përpiqej të thyente një kub akulli brenda të cilit gjendej një kanace kapucinoje.
- Përmbajtja audiovizive e reklamës në fjalë ishte ideuar për të evidentuar risitë e produktit që reklamohet, siç

ishte promovimi për herë të parë i linjës së ftohtë të kafes Lori në një sezon të nxehtë veror.

- Përfshirja e modeles me rroba banjo në reklamë dhe çdo element tjetër freskues i shërbente marrëdhënies me produktin dhe reklamimit të tij.
- Reklama e DigitAlb promovonte përmes skeçit humoristik ofertat televizive të DigitAlb për sezonin e ri teksa kjo realizohej përmes dialogut satirik mes modeleve me rroba banje dhe aktorit të humorit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave gjykoj se përmbajtja audiovizive e reklamës së DigitAlb ishte fokusuar në evidentimin e risive të ofertave të DigitAlb ndërsa dialogu me modelet e përfshira ironizonte një pjesë të realitetit nëpërmjet humorit. Ndaj dhe gjykimi i punës artistike, krijimtarisë, skeçeve apo çdo forme arti tjetër argëtues apo humoristik duhej parë edhe në një këndvështrim tjetër për sa kohë përmes dialogut satirik të personazheve vihen në lojë dhe demaskohen kategoritë që i përkasin

shtresave që ata përfaqësojnë.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se përmbajtjet për të cilat ankohej ankuesi nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 97/ 2013

"Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Dhjetëra ankues	Top Channel	Reklamë	21.08.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori dhjetëra ankesë në lidhje me spotin publicitar të "DigitAlb" përmes së cilës ankuesja pretendonte se "promovonte aktivitetin e jashtëligjshëm..., stilin e jetës jo në përputhje me realitetin si dhe diskriminonte figurën e grave, duke i paraqitur si objekte kënaqësie, të cilat shpërblehen për këtë...". Ankuesit kërkonin ndryshimin e orarit të transmetimit të saj.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi videon në fjalë dhe evidentoi disa elementë:

- *Reklama e DigitAlb promovonte përmes skeçit humoristik ofertat televizive të DigitAlb për sezonin e ri teksa kjo realizohej përmes dialogut satirik mes modeleve me rroba banje dhe aktorit të humorit.*
- *Këshilli i Ankesave gjykoi se përmbajtja audiovizive e reklamës së DigitAlb ishte fokusuar në evidentimin e risive të ofertave të DigitAlb ndërsa dialogu me modelet e përfshira ironizonte një pjesë të realitetit nëpërmjet humorit.*
- *Ankueses iu vu në dukje se personazhi në fjalë ishte një aktor i njohur i humorit i cili njihet për kritikën ndaj fenomeneve negative të shoqërisë përmes skeçeve të humorit dhe përdorimit të ironisë në spektakle të*

ndryshme humoristike.

- *Demaskimi i fenomeneve përmes satirës dhe humorit është qasje e njohur edhe më herët jo vetëm në median shqiptare por edhe atë botërore.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se gjykimi i punës artistike, krijimtarisë, skeçeve apo çdo forme arti tjetër argëtues apo humoristik duhej parë edhe në një

këndvështrim tjetër për sa kohë përmes dialogut satirik të personazheve vihej në lojë dhe demaskoheshin kategoritë që ata përfaqësonin.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se përmbajtja për të cilën ankohej shtetasja

1.S nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Sh.Zh	Vizion + Syri TV	Edicion Informativ	16.06.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori një ankesë nga Sh.Zh përmes së cilës ankuesi pretendonte se mediat "Vizion Plus", "Syri TV" në kanalën zyrtar të shpërndarjes së videove "YouTube" kishin publikuar pamjet e rënda të aksidentit të oficerit të Policisë, G.Zh ndodhur në Balldre të Lezhës.

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave kreu verifikimet e duhura, nga ku rezultoi se në kanalet zyrtare të Vizion Plus dhe Syri TV në "YouTube", ishin transmetuar pamjet e viktimës pa përdorur teknologjinë e përshtatshme për mbulimin e tyre.

Këshilli i Ankesave i solli në vëmendje operatorit përkatës se platforma e shpërndarjes së videove "YouTube", kompetencat, që ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e

Shqipërisë", i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023) i jep AMA-s si autoritet rregullator, prekin veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve.

Konkretisht, neni 2 i ligjit parashikon se objekt zbatimi i tij janë transmetimet audiovizive lineare (të transmetuara në kohe reale), transmetimet audiovizive jolineare (video-on-demand), shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përmbushje të dispozitave ligjore që ngarkon ligji nr.97/2013 dhe Kodi i Transmetimit, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i kërkoi operatorëve "Vizion Plus" dhe "Syri TV" përdorimin e teknologjisë së mbulimit, në këtë video, në respekt të dinjitetit të të ekspozuarit dhe ndjeshmërinë e të afërmve.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Linja e këshillimit për gratë dhe vajza	-	Lajm	29.08.2024

1. Objekti i Ankesës

Linja e këshillimit për gratë dhe vajza dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se *"shpërndarja e pamjeve video që tregon inxhinierin e plagosur z.L.K, dhe oficerin e policisë z.E.G, që e kërcënon dhe fyen vazhdimisht pas të shtënave, është transmetuar gjerësisht dhe mbetet e aksesueshme në platforma të ndryshme online"*. Sipas ankueses, kjo video *"ishte transmetuar pa asnjë fshehje apo përpjekje për të mbrojtur identitetin e viktimës dhe se në transmetimin e parë të videos nuk ka përdorur asnjë filtër"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës u evidentua se të dhënat e përftuara nga verifikimet e Këshillit nuk përkonin plotësisht me pretendimet e ankueses. Ndaj iu kërkua që në shërbim të administrimit të ankesës, të plotësonin elementët e saj, duke detajuar të dhënat përkatëse, me "Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), formatin audioviziv, datën dhe orën e transmetimit". Të dhëna të domosdoshme për trajtimin e mëtejshëm të ankesës.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Studio ligjore "Muja"	Media+Portale	Artikull	01.10.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori dijeni për një ankesë nga Studio Ligjore "EMuja Law" drejtuar disa mediave dhe portaleve në vend, me pretendimin se ndaj një klienti të tyre ka patur: *"Shkelje të drejtës së privatësisë dhe publikimi i të dhënave personale pa asnjë autorizim"*, në një kohë që hetimi vijonte.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes në dijeni të çështjes, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbajti nën vëzhgim reagimin e OSHMA-ve mbi problematikën e parashtruar nga ankuesi deri në zgjidhjen e saj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
B.R.	Google	Artikull	01.10.2024

1. Objekti i Ankesës

B.R dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se *"në motorin e kërkimit "Google", shfaqen lajme të pavërteta, në cenim imazhi"*. Ndaj ai i kërkoi Autoritetit fshirjen e këtyre materialeve që i dëmtonin imazhin.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të shqetësimit të ankuesit, Këshilli i Ankesave verifikoi shpërndarësin e këtij informacioni, nga ku rezultoi se pretendimi i tyre i referohej motorit të kërkimit "Google.com". Ankuesit ju bë me dije se platforma e mësipërme bie jashtë juridiksionit dhe objektit të

veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive i cili është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu ankuesi u informua se veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive bazohet në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", mediat online vijojnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
OMSA	MCNTV	Xhadat	15.10.2024

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e organizatës "OMSA" nisën një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në adresë të emisionit "Xhadat", transmetuar në televizionin "MCNTV" më datë 14.10.2024. Ankuesit pretendonin se përmbajtja audiovizive kishte materiale që përbënin kërcënim serioz për komunitetin LGBTIQ dhe individët e përfshirë. Gjithashtu, pretendohet se ishte përdorur një fëmijë për të paraqitur një realitet të shtrembëruar dhe për të manipuluar opinionin publik.

2. Administrimi i Ankesës

Bazuar në nenin 51 të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit "MCN" fillimisht paraqitjen

e pretendimeve.

Më pas, bazuar si në ankesën e paraqitur ashtu edhe në pretendimet e paraqitura nga "MCNTV", bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, pika 6, Këshilli i Ankesave organizoi një seancë dëgjimore me palët, në zyrat e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Gjatë seancës, ankuesi u qëndroi pretendimeve mbi rrezikshmërinë e ekspozimit në emisionin "Xhadat", të datës 14 Tetor 2024 për pjesëtarët e komunitetit LGBTIQ, si dhe përdorimi i fëmijës për të manipuluar opinionin publik, kërkoi kërkuar heqjen e përmbajtjes audiovizive përkatëse nga llogaritë e "MCNTV" në platformat e shpërndarjes së videove.

Përfaqësuesi i OSHMA-së, nga ana e tij u qëndroi pretendimeve të OSHMA-së, të paraqitura edhe me shkrim, duke e vënë theksin te nevoja e kufizimeve moshore për pjesëmarrjen në aktiviteteve të tilla, çka – sipas tij – ka shërbyer si shtysë edhe për investigimin në fjalë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas këqyrjes së përmbajtjes audiovizive, dëgjimit të palëve dhe shqyrtimit të materialit publicitar, të vënë në dispozicion nga palët, Këshilli i Ankesave, evidentoi disa problematika, të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore të ligjit nr.97/2013 dhe Kodit të Transmetimit.

Nisur nga sa më sipër, në emër të interesit më të lartë të fëmijës, me synimin, që ky rast të mos shndërrohej në precedent për median, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i Tërhoqi vëmendjen për shmangie nga detyrimet, që parashikon

Ligji nr.97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendimin nr. 60, datë 10.07.2023 të Bordit të AMA-s.

Për sa më sipër, bazuar edhe në ligjin nr.97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Këshilli i Ankesave e konsideroi të mbyllur administrimin e ankesës.

Pas marrjes në dijeni të çështjes, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbajti nën vëzhgim reagimin e OSHMA-ve mbi problematikën e parashtruar nga ankuesi.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Gj.P.	Media+Portale	Artikull	01.10.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori dijeni për një ankesë nga Studio Ligjore "EMuja Law" drejtuar disa mediave dhe portaleve në vend, me pretendimin se ndaj një klienti të tyre ka patur: "Shkelje të drejtës së privatësisë dhe publikimi i të dhënave personale pa asnjë autorizim", në një kohë që hetimi vijonte.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes në dijeni të çështjes, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbajti mbajti nën vëzhgim reagimin e Operatorëve të Shpërndarjes së Videove mbi problematikën e parashtruar nga ankuesi.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
I.K.	TV Klan	Opinion	05.11.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë përmes së cilës shprehej shqetësimi se "në emisionin "Opinion" me titull "Çfarë ka ndodhur tek Onkologjiku?", transmetuar në "TV Klan" në datën 04.11.2024 në orën 22:00. Sipas ankueses analisti i ftuar në studio, L.Gj kishte deklaruar se: "njerëzit e sëmurë me kancer i ka dënuar Zoti me vdekje, një shprehje e rëndë që lëndon thellësisht ata që po përballen me sëmundjen". Ankuesja pretendonte se deklaratat ishin diskriminuese dhe media do duhej të kishte reaguar.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Klan", paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën. Në kthim përgjigjen e tyre, nr.1425/1, prot., 20.11.2024, protokolluar me tonën nr. 3159/1 datë 25.11.2024, OSHMA-ja, bëri me dije se: "një opinion i shprehur gjatë diskutimit

në studio nga një prej të ftuarve, nuk përfaqësojnë kurrsesi opinionet apo qëndrimin e këtij të fundit si OSHMA".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, emisioni "Opinion", transmetuar në televizionin "Klan" në datën 04.11.2024 ora 22:00, Këshilli i Ankesave evidentoi se L. Gj i ftuar në studio për të diskutuar në lidhje me temën me titull "Çfarë ka ndodhur tek Onkologjiku?", shprehej se: "Tema është shumë e dhimbshme. Flasim për njerëz që i ka dënuar Perëndia me vdekje që herët a vonë nëse do të kuroheshin në Tiranë, Nju Jork, Paris, Berlin, a kudo gjetkë fundi i tyre do të ishte shumë i dhimbshëm. Shumica e humbet këtë betejë herët a vonë..". Përkundrajt, pretendimeve të OSHMA-së, moderator i kurrsesi nuk dënonte deklaratën e analistit. Autoriteti i Mediave Audiovizive, si autoritet rregullator AMA vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën

e Shqipërisë i bëri me dije se liria e shprehjes nuk është absolute dhe ajo mund të kufizohet, sidomos kur ka përmbajtje të një gjuhe të papërshtatshme, që nxit urrejtje ose qëndrime në cenim të dinjitetit dhe integritetit. Referuar dispozitave të ligjit për mediat audiovizive, duhet që

mediat audiovizive në transmetimet tuaja audiovizive apelon për zbatimin në përputhje me liritë dhe të drejtat, themelore të njeriut, lirinë e shprehjes dhe të informimit, respektimin e dinjitetit, paanësisë së informacionit. Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen për shmangie të Ligjit nr.97/2013.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
M. D.	Top Channel	Fiks Fare	20.11.2024

1. Objekti i Ankesës

M. D. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se në emisionin "Fiks Fare", transmetuar në Top Channel, në datë 5 Nëntor 2024, ishin publikuar materiale pa prova dhe fakte në cenim të integritetit dhe dinjitetit të saj si mësuese. Gjithashtu ankuesja pretendonte se media nuk e kishte marrë në pyetje për të dhënë versionin e saj.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive prej së cilës evidentoi :

- *emisioni trajnonte rastin e bullizimit të një fëmije nga mësuesja,*
- *publikohej denoncimi i së ëmës së nxënësit ndaj sjelljes abuzive të mësueses për të cilën deklarohet se ishte ankuar te mësuesja kujdestare dhe drejtoresha e shkollës,*
- *publikohej dokumenti në përmbajtje të të cilit ishin ankesat që prindër të ndryshëm kishin bërë ndaj mësueses,*
- *publikohej gjithashtu dokumenti që përmbante masën disiplinore nga*

Komisioni i Etikës,

- *publikohej ankesa që prindërit i kishin drejtuar zyrës së bashkëqeverisjes,*
- *publikohej dokumenti që përmbante ankesën drejtuar Zyrës Vendore Arsimore Tiranë,*
- *publikohej biseda e prindit të nxënësit me psikologun e shkollës dhe mësuesen kujdestare,*
- *intervistë e psikologes së shkollës,*
- *intervistë mësueses së italishtes,*
- *publikohej vendimi i Komisionerit për mospranimin e ankesës së mësueses për diskriminim.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se emisioni "Fiks Fare" i datës 05.11.2024 gjatë trajtimit të rastit të bullizimit të një nxënësi në klasën e gjashtë nga mësuesja e shkollës i shërbente interesit të fëmijës dhe njëkohësisht informimit të opinionit publik. Emisioni ishte realizuar bazuar në referencat e dokumenteve zyrtarë.

Në vendimmarrjen e tij Këshilli i Ankesave konkludoi se "trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë

tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme", ishte

konform ligjit nr. 97/2013, "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
L.Sh.	Top Channel	Përputhen	25.11.2024

1. Objekti i Ankesës

L. Sh i shprehu shqetësimin Këshillit të Ankesave në lidhje me emisionin "Për 'puthen", transmetuar në Top Channel me pretendimin se në orarin e transmetimit ky emision kishte përmbajtje të papërshtatshme për të gjitha moshat. Ndaj ankuesi i kërkoi Autoritetit të Mediave Audiovizive rishikimin e orarit të transmetimit të emisionit, me fokus mbrojtjen interesit më të lartë të fëmijëve.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së shqetësim-ankesës së qytetarit, Këshilli i Ankesave i bëri me dije se:

- "Autoriteti i Mediave Audiovizive e ka pasur dhe vijon ta ketë nën vëzhgim formatin audioviziv "Për 'puthen", pjesë e strukturës programore të televizionit Top Channel.
- Shkeljet apo shmangiet nga detyrimet e parashikuara në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 60,

datë10.07.2024 janë bërë objekt i disa vendimmarrjeve paralajmëruese ose sanksionuese nga ana e Autoritetit, përputhur me peshën e secilës prej tyre.

- *Hartimi i grilës programore dhe sistemimi i formateve në të, janë pjesë e politikës editoriale të OSHMA-ve dhe për pasojë jashtë ndikimit dhe vendimmarrjes së Autoritetit, i cili në raste të tilla mund të rekomandojë, por kurrësi të diktojë fashat orare.*
- *Në vendimmarrjen dhe kompetencat e Autoritetit – siç e kërkon edhe ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 60, datë10.07.2024 - është kërkesa për plotësimin e detyrimit për vendosjen e sinjalistikës, me synim orientimin e prindërve, të cilin OSHMA e ka përmbushur".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave siguroi ankuesin çdo ankesë do trajtohet me seriozitet

në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "*Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023 si

edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre.

2

Ankesa me objekt

"cenimin e të drejtave

të fëmijëve"

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
R.R.	Top Channel	Edicion Informativ	18.08.2024

1. Objekti i Ankesës

R. R i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) me pretendimin se në kronikën me titull "Dorëzoi portofolin/ Historia e 14 vjeçarit nga Shkodra që na bën të ndjehemi krenarë", transmetuar në televizionin Top Channel në edicionet informative.

Ankuesja pretendonte se "edhe pse gjesti i 14-vjeçarit që i riktheu portofolin e humbur një turisteje ishte për t'u lavdëruar, kronika promovonte shkeljen hapur të Kodit të Punës, përkatësisht nenin 78", pasi fëmija rezultonte i punësuar nën moshën e lejuar nga ligjet shqiptare.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes" si edhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit Top Channel paraqitjen e pretendimeve të tyre lidhur me ankesën e sipërcituar.

Ankesa e paraqitur nga: Subjekti audioviziv Programi Data

ASHMDF

Euronews Albania Edicion Informativ 11.01.2024

1. Objekti i Ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në lidhje me publikimin e lajmit të abuzimit të një vajze të mitur 12 – vjeçare në Pogradec *"... në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së fëmijëve. Është intervistuar me zë dhe figurë nëna e vajzës 12 - vjeçare të abuzuar, duke bërë të mundur identifikimin e saj indirekt në media, në cenim të të drejtave të fëmijës. Gjatë intervistës janë publikuar të dhëna dhe detaje të abuzimit që çojnë në dëmtimin e dinjitetit dhe moralit të vajzës 12 - vjeçare të abuzuar".*

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, pas verifikimeve të kryera lidhur me raportimin mediatik të rastit të abuzimit të dyshuar seksual të së miturës 12-vjeçare në Pogradec, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s nuk konstatoi identifikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të 12 – vjeçares së dyshuar të

abuzuar në transmetimet audiovizive të monitoruara në datat përkatëse në zbatim të

Ligjit nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, sipas të cilit:

- *"veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të vecantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve". (Neni 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 1/b),*
- *"në programet e transmetuara nga OSHMA-të të mos çenohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit". (Neni 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/ç),*

si edhe

- Të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, sipas të cilit:

"Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi

i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta". (Seksioni 1, "Parimet themelore", pika 1.4).

"Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta". (Seksioni 4, "Fëmijët në transmetimet audio dhe audiovizive", në nënseksionin

"Ndalimi i identifikimit të fëmijës", pika 4.24).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa më sipër, duke vlerësuar ruajtjen e standardeve profesionale të raportimit korrekt të lajmit në subjektin audioviziv, Euronews Albania, të monitoruar nga AMA, në emër të interesit më të lartë të fëmijës, Këshilli i Ankesave i dërgoi një shkresë sensibilizuese operatorit përkatës të reflektonte të njëjtat standarde edhe në llogarinë e tij në YouTube duke hequr videon përkatëse!

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Me vetë inicim	OSHMA	Lajme	25.11.2024

1. Objekti i Ankesës

Ngjarja e rëndë e ndodhur më 18.11.2024 në Tiranë, u përcoll me shqetësim nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Mbulimi i dinamikës së ngjarjes dhe kërkimi i shkaqeve, që e shtynë grupin e adoshelentëve drejt dhunës, si pasojë e së cilës humbi jetën njëri prej tyre dhe u plagosën disa të tjerë, nga shumica e mediave audiovizive kishte profesionalizëm dhe kujdes, që raportimi të mos lëndojë më shumë familjarët dhe të afërmit, në respekt të dhimbjes dhe dëshpërimit të tyre. Megjithatë, gjatë monitorimit u evidentua publikim të dhënash dhe hollësish të panevojshme apo të pakonfirmuara, të cilat përbënin abuzim, me synim shfrytëzimin e ngjarjes nga këndvështrimi sensacional, duke lënë pas anën e saj njerëzore.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në emër të interesit më të lartë të fëmijës, respektit ndaj dhimbjes së familjarëve, ndjeshmërisë së mbarë opinionit publik shqiptar dhe detyrimit shoqëror gjithëpërfshirës, për të mos lejuar, që ngjarje të tilla të shndërrohen në precedent, Autoriteti i Mediave Audiovizive i bëri thirrje për profesionalizëm dhe përgjegjësi maksimale, përputhur me standardet e parashikuara në ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kodin e Transmetimit dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i cili nga ana e vet, vijoi monitorimin e transmetimeve, do të shqyrtojë çdo rast të mosrespektimit të kërkesave ligjore, duke ua adresuar ato redaksive respektive. Pritshmëria e Autoritetit është pasqyrimi sa profesional aq edhe etik i ngjarjes, në respekt të dhimbjes, ndjenjave dhe dinjitetit të të prekurve.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.E & L.H	Syri TV	Piranjat	25.11.2024 03.12.2024

1. Objekti i Ankesës

A.E & L.H i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe në (AMA), me objekt *"Shkeljen e etikës gazetareske dhe cenimin e të drejtave të privatësisë nga Syri TV dhe emisioni "Piranjat"*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të Syri TV, paraqitjen e pretendimeve në lidhje me këtë ankesë. Në përgjigjen e tyre, OSHMA-ja bëri me dije procedurat dhe hapat e ndjekur për realizimin e emisionit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit "Piranjat", transmetuar në televizionin Syri TV në datën 29.11.2024 në orën 20:45 dhe vijimin e trajtimit të çështjes në emisionin "Piranjat" transmetuar në televizionin Syri TV në datën 06.12.2024 në orën 20:45. Nga këqyrja e materialit

evidentoi se emisioni trajtonte rastin e largimit nga familja të një vajze 18 – vjeçare, me çrregullim të spektrit autik dhe prapambetje mendore të moderuar (niveli i tretë). Familjarët e shqetësuar i ishin drejtuar për ndihmë emisionit "Piranjat", të cilëve iu kërkohesh mbështetja për ta sjellë në shtëpi fëmijën e tyre. Në publikimet e transmetuara, stafi i emisionit kishte përdorur efektet blur dhe teknologjinë e nevojshme për mosidentifikimin e personave të përfshirë në emision. Bazuar në samë sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se emisioni "Piranjat" i datës 29.11.2024 dhe ai i datës 06.12.2024 gjatë trajtimit të rastit të largimit të 18 – vjeçares, me çrregullim të spektrit autik dhe prapambetje mendore të moderuar (niveli i tretë) nga ambientet e shkollës pa dijeninë e familjarëve i shërbente në radhë të parë interesit të vetë vajzës me probleme shëndetësore, familjarëve të shqetësuar të cilët ishin drejtuar vetë për ndihmë tek stafi i emisionit dhe njëkohësisht informimit të opinionit publik në lidhje me trajtimin e çështjeve kaq sensitive. Informacionet e publikuara nga stafi i emisionit i referoheshin dokumenteve zyrtarë të lëshuara nga institucionet e

Republikës së Shqipërisë në realizim të misionit të gazetarisë për informimin e publikut në lidhje me çështje që përbëjnë interes publik. Si përfundim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk konstatoi

shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.D.	Top Channel	Inside Story	06.12.2024

1. Objekti i Ankesës

E.D i kërkoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) marrjen e masave ndaj emisionit "Inside Story", transmetuar në Top Channel në datë 6 dhjetor 2024 në orën 21:00. Ankuesi pretendonte se në emision ishte transmetuar foto e fëmijës së tij, për një ngjarje të cilin nuk kishte asnjë lidhje.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave verifikoi përmbajtjen audiovizive përkatëse të emisionit

"Inside Story" konstatoi publikimin e fotografisë së pretenduar në minutën 21:09:23 dhe 21:09:45 dhe i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-së "Top Channel", paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën tuaj dhe në rast keqinformimi marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e fotos. Me shkresën me nr.3384/1prot., datë 23.12.2024, televizioni "Top Channel" bëri me dije se: "*Duke shprehur ndjesë për shqetësimin e shkaktuar, theksojmë se janë marrë masa të menjëhershëm sapo jemi vënë në dijeni nga ana juaj nëpërmjet kësaj shkrese duke hequr foton në You Tube sipas sekuencave të sqaruara ne ankesë*". Pas verifikimeve të kryera nga Këshilli i Ankesave në videon përkatëse rezultoi se foto e pretenduar ishte hequr.

3

*Ankesa jashtë
juridiksionit*

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.N.	Report TV	"Pa Gjurmë"	07.07.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë me objekt denoncimin e disa rasteve për: "disinformim dhe përhapjen me qëllim të informacionit të rremë", përkitazi emisionit "Pa gjurmë", transmetuar në Report TV, me pretendimin për "përhapjen e informacionit të rremë me qëllim..., duke vënë në rrezik jetën e personave" dhe "kryerjen e të paktën 5 kundërvajtjeve penale", si: "regjistrimi i zërit, fiksimi dhe transmetimi pa dhënë pëlqim, deformim informimi. , etj."

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë administrimit të ankesës së sipërpërmendur, ankuesit ju bëjmë me dije se:

- Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 52, "Shqyrtimi i ankesave", "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë". Bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive, së cilës ankuesi i referohej nuk mund të ishte objekt shqyrtimi, pasi ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në lidhje me pretendimet e tij mbi kundërvajtjet penale gjatë zhvillimit të emisionit, ankuesi u sqarua se kategorizimi i njëveprimit të tillë në veprë penale ose jo, del jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
K.C.	Film	"Nëntori i dytë"	03.10.2024

1. Objekti i Ankesës

K. C i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se filmi "Nëntori i Dytë", realizuar gjatë periudhës së regjimit diktatorial nuk ishte mbështetur në fakte historike të vërteta, por ishte ndikuar nga fenomene të artit socialist të kohës, me konotacione negative për këtë ngjarje historike...". Sipas ankuesit *"...skenari i filmit...ka kaluar në shtrembërime dhe madje mashtrime me të vërtetat e ngjarjeve dhe aktorëve historikë"*.

2. Administrimi i Ankesës & qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesit iu bë me dije se kauza në fjalë edhe më herët kishte tërhequr vëmendjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive ndërsa kjo temë ishte diskutuar edhe në një prej takimeve

të AMA-s (2017) me përfaqësues të Institutit të Integritimit të ish të Përndjekurve Politikë në Tiranë. Pas konsultimeve ishte rënë dakord se nevojitet të bëhej një vlerësim i krijimtarisë filmike dhe dokumentare të periudhës së para viteve '90 dhe së dyti duhej një vendimmarrje për mënyrën e transmetimit publik të saj.

Në kuadrin e administrimit të ankesës, ankuesi u informua se AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe se shqetësimi i tij nuk lidhej me produkte audiovizive të televizioneve por me vepra kinematografike që janë prodhuar në një kontekst tjetër.

Për rrjedhojë, vendimi dhe vendimmarrja janë dy procese që e tejkalojnë kompetencën ligjore dhe rregullative të AMA-s.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
G.S.	JOQ	Lajm	17.10.2024

1. Objekti i Ankesës

L.GJ kërkoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) marrjen e masave ndaj një OSHMA-ja me pretendimin se gjatë një debati televiziv, deklaratat e saj ishin nxjerrë jashtë kontekstit, duke krijuar keqkuptime në dëm të saj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankueses plotësimin e të dhënave në kuadër të administrimit të saj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Xh.K.	Politiko.al Telegraf.al Panorama.com.al Arkivalajmeve.com Mcntv.al Noa.al Opinion.al Gazetainfokus.com Starplus-tv.com Përqasje.com	Lajm	13.11.2024

1. Objekti i Ankesës

Xh. K i kërkoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) fshirjen e të dhënave personale të publikuara në disa media online, me pretendimin se përmbante të dhëna sensitive dhe mjaft problematike, që lidheshin me një konflikt familjar.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli

i Ankesave evidentoi mungesën juridiksionit veprues me objekt ankesën. Konkretisht, ankueses iu bë me dije se bazuar në ligjin 97.2013, neni 2 "Fusha e zbatimit", përcakton se "ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Mediat online dhe portalet janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Pra, mediat online, rrjetet sociale vijojnë të jenë jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.F.	Gazetakorrieri.com Gazetajone.com Gazetaimpakt.com	Artikull	26.11.2024

1. Objekti i Ankesës

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë prej z.A.F, me objekt: *"Kërkesë zyrtare për marrjen e masave ndaj portaleve, që dëmtojnë imazhin"*.

Ankuesi pretendonte se portalet Gazetakorrieri.com, Gazetajone.com, Gazetaimpakt.com i kishin dëmtuar imazhin dhe reputacionin e biznesit, nëpërmjet publikimit të përmbajtjeve të manipuluar dhe të pavërteta. Në pamundësi, pasi portalet nuk kishin adresa par t'i kontaktuar direkt, ankuesi kërkonte ndërhyrjen e AMA-s, për të ndërmarrë masa ligjore.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesin, se

Autoritetit i mungonin hapësira ligjore për administrimin e saj.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive, vepron bazuar dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili *"... zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre"*. Mediat online (portalet) vijojnë të jenë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", mediat online (portalet) vijojnë të mbeten jashtë objektivit të veprimtarisë së Autoritetit.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
G.S.	Pamfleti (web +YouTube)	Artikuj	27.11.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga G. S me pretendimin se "Pamfleti" në web dhe në YouTube "ka dhënë informacion të pavërtetë duke dëmtuar financiarisht personin dhe biznesin e tij në Shqipëri".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës tuaj, Këshilli i Ankesave pranë

Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi se materialet e referuara prej ankuesit ishin publikuar në kanalën e shpërndarjes së videove "YouTube". Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023) konkretisht, neni 2 i ligjit i jep AMA-s si autoritet rregullator kompetencë edhe mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve. Megjithatë, në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës You Tube në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi të.

4

Ankesa jashtë

afatit

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.N.	Media	Video	16.05.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit

A. N me objekt denoncimin, sipas tij, të disa rasteve për: *"disinformim dhe përhapjen me qëllim të informacionit të rremë", përkitazi emisionit "Pa gjurmë", transmetuar në Report TV, në datat 09.03.2023 & 10.03.2023 ora 16:00". Ankuesi pretendonte për "përhapjen e informacionit të rremë me qëllim...., duke vënë në rrezik jetën e personave" dhe "kryerjen e të paktën 5 kundërvajtjeve penale", si: "regjistrimi i zërit, fiksimi dhe transmetimi pa dhënë pëlqim, deformim informimi. , etj."*

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i materialit të ankuesit, bazuar në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 52, "Shqyrtimi i ankesave", Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa duhej të ishte paraqitur në formë të shkruar brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më

shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë. Referuar dispozitës ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive, së cilës i referohej ankuesi ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara. Në lidhje me pretendimet e tij për kundërvajtje penale gjatë zhvillimit të emisionit, iu sqarua se kategorizimi i një veprimi të tillë në vepër penale ose jo, bie jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij për përcaktim të ankesës jashtë afateve ligjore, Autoriteti i Mediave Audiovizive e siguroi ankuesin se do të vazhdojë të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që vijnë për shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023 si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.A.	Portal	-	11.08.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi E.A me anë të së cilës kërkoi *"mbylljen e një portali të paregjistruar..."*.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës,

Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit se *"referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2,"Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre", gjithashtu u sqarua se mediat online dhe portalet vijnë të mbeten jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.*

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.D.	Euro News	-	21.08.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi

E.D me objekt "*veshjen e ... gazetarit E.B, ... me fanellën e kombëtares serbe..., në një intervistë live në Euro News*". Ankuesi i kërkoi Autoritetit të Mediave Audiovizive "*të ndër marrë hapat e duhura, për simbolikën në publik*".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën, evidentoi se përmbajtja së cilës i referohej ankuesi dilte jashtë tagrit ligjor të veprimt të Autoritetit. Konkretisht, kompetencat e Autoritetit të Mediave Audiovizive, rregullohen me ligjin nr. 97/2013, "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "*Fusha e zbatimit*", (ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë

13.4.2023) . Pra, dispozita ligjore saktëson veprimtarinë e AMA-s e cila shtrihet në transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe shërbimet e platformave të shpërndarjes së videoeve.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave sqaroi ankuesin se për sa kohë ankesa e tij nuk prekte përmbajtjen audiovizive dhe nuk përmbantemesazhe urrejtjeje racore, gjinore, fetare, etnike, kombëtare apo çdo lloj forme tjetër diskriminimi dhe nuk cenonte dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut apo normat morale të shoqërisë,, veshja e të ftuarit mbetet pjesë e të drejtave themelore të individit dhe gjithsesi jashtë fushës së veprimtarisë së ligjit të sipërpërmendur dhe kompetencave të AMA-s, të sanksionuara në këtë ligj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
I.T.	"Prapaskena.com"	Shkrim	10.09.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga I.T, në lidhje me një shkrim të publikuar në portalin "Prapaskena.com", me pretendimin se *"cenonte në mënyrën më vulgare dhe brutale nderin dhe reputacionin e tij"*. Ankuesi pretendonte se, *"portali <https://prapaskena.com/> vepron i paregjistruar në QKB"*.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit", "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Mediat online dhe portalet vijojnë të jenë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në lidhje me të tjera formulime, ku ai pretendonte se ishte përdorur ndaj tij mashtrime deri në shpifje, ju bë me dije se shpifja nuk trajtohet nga dispozitat ligjore, tagër i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
I.B.	Facebook	Video	24.09.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga I.B me objekt: "Denoncim për një media në Facebook Lushnja Info" me pretendimin se:

- *"video e hedhur ka denigruar kontekstin e aktivitetit,*
- *ka prishur imazhin e shumë njerëzve dhe më ka shkaktuar në familje shqetësime".*

Ndaj ankuesja kërkonte nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të mbyllte faqen në "Facebook".

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, ankueses iu bë me dije se :

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive, vepron bazuar dhe në

zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe referuar këtij ligji, denoncimet nuk janë pjesë e kompetencave të tij.

- Në vijim, u sqarua se bazuar në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni Neni 30/1 "Ofruesit e shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë"

(shtuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.4.2023) përcakton se "Ofruesi i shërbimit të platformave të shpërndarjes së videove është në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë kur zyra apo struktura drejtuese e tij është në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rrjeti social "Facebook", pjesë e platformës "Meta" nuk ka regjistrim në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për pasojë është jashtë juridiksionit të autoritetit të Mediave Audiovizive.

Si përfundim ankuesaj u informua se Autoritetit i mungon hapësira ligjore për administrimin e ankesës së saj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.N.	Media	Video	16.05.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit

A. N me objekt denoncimin, sipas tij, të disa rasteve për: *"disinformim dhe përhapjen me qëllim të informacionit të rremë", përkitazi emisionit "Pa gjurmë", transmetuar në Report TV, në datat 09.03.2023 & 10.03.2023 ora 16:00". Ankuesi pretendonte për "përhapjen e informacionit të rremë me qëllim..., duke vënë në rrezik jetën e personave" dhe "kryerjen e të paktën 5 kundërvajtjeve penale", si: "regjistrimi i zërit, fiksimi dhe transmetimi pa dhënë pëlqim, deformim informimi. , etj."*

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i materialit të ankuesit, bazuar në ligjin nr. 97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, konkretisht neni 52, *"Shqyrtimi i ankesave"*, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa duhet të ishte paraqitur në formë të shkruar brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më

shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë. Referuar dispozitës ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive, së cilës i referohej ankuesi ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara. Në lidhje me pretendimet e tij për kundërvajtje penale gjatë zhvillimit të emisionit, iu sqarua se kategorizimi i një veprimi të tillë në vepër penale ose jo, bie jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij për përcaktim të ankesës jashtë afateve ligjore, Autoriteti i Mediave Audiovizive e siguroi ankuesin se do të vazhdojë të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që vijnë për shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 *"Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë"* dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023 si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre.

5

Komunikime tregtare

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
AWA, AWEN, GADC	Top Channel	Reklama	14.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Koalicioni kundër seksizmit (AWA, AWEN, GADC) përmes një shkrese dërguar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i kërkoi Këshillit të Ankesave heqjen e reklamës së Lori Caffè-së që shfaqej në "Top Channel", pasi sipas tyre seksualizonte figurën e femrës, konkretisht përmes Rike Roçit, duke përdorur trupin e saj për të tërhequr vëmendjen për produktin e tyre, kafënë e ftohtë në kanaçe. Koalicioni pretendonte se shfaqja e një komunikimi tregtar të tillë, kishte ndikim negativ në perceptimet shoqërore për rolet gjinore dhe forcimin e stereotipeve të dëmshme.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës,

Këshilli i Ankesave shqyrtoi rastin dhe evidentoi se reklama e Lori Caffè-së promovonte linjën e re të kafesë së ftohtë, e cila ilustrohej nga një modele e veshur me rroba banje teksa përpiquej të thyente një kub akulli brenda të cilit gjendej një kanaçe kapuçinoje.

Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave gjykoi se përmbajtja audiovizive e reklamës në fjalë ishte ideuar për të evidentuar risitë e produktit që reklamohej, sikurse ishte promovimi për herë të parë i linjës së ftohtë të kafes Lori në një sezon të nxehtë veror. Si përfundim, përfshirja e modeles me rroba banjo në reklamë dhe çdo element tjetër freskues i shërbente marrëdhënies me produktin dhe reklamimit të tij.

6

Të ndryshme

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
F.B.	Top Albania Radio	"Ndryshe"	22.07.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave mori një kërkesë për informacion, bazuar në ligjin nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", me objekt: "*një rast të paprecedentë të gjuhës seksiste që përfshin regjisorin Bujar Kapexhiu... tek emisioni "Ndryshe" transmetuar në Top Albania Radio, ku ndër të tjera ankuesja pyeste edhe nëse:*

- A e ka parë Këshilli i Ankesave këtë deklaratë? – Nëse po, si e ka konsideruar? A u qëndron kjo deklaratë parimeve që nuk duhen cenuar?
- A ka pasur Autoriteti i Mediave Audiovizive kontakte me zotin Kapexhiu pas kësaj deklaratë apo me ndonjë nga drejtuesit e programit "Ndryshe" ku dhe është bërë deklarata?
- Si do të vepohet me këtë rast që duhet hapur se kemi të bëjmë me një shkelje të parimeve që nuk duhen cenuar, përfshirë dinjitetin e grave që kanë kontribuar në komedi?

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës/kërkesës për informacion, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesen si më poshtë vijon:

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.22/20162, datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017, nr. 30/2023, datë 13.4.2023, si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive. Bazuar në këtë ligj, "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë", neni 4, pika1/a). Gjithashtu, një ndër objektivat e veprimtarisë së AMA-s është "të sigurojë ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias" (neni 18, pika1/b).
- AMA, në procesin e monitorimit

të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka vërejtur se gjatë emisionit "Ndryshe", datë 11.06.2024, nuk janë respektuar kërkesat ligjore. Përmes shkresës nr.2016, prot, datë 01.07.2024, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i tërhoqi vëmendjen "Top Albania Radio" për mosrespektim të Ligjit Nr.97/2013, në emisionin "Ndryshe", datë 11.06.2024, ora 18:00.

- Në lidhje me pyetjen e saj "A ka pasur Autoriteti i Mediave Audiovizive kontakte me zotin Kapexhiu...", iu bë me dije, se AMA, si autoritet

rregullator, që vepron sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i ka marrëdhëniet e saj me Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive, të cilët kanë përgjegjësi editoriale, nuk ndërhyjnë në politikën editoriale të tyre dhe nuk kontakton të ftuarit e tyre.

- Duke mirëkuptuar shqetësimin e ankueses për "shkelje të parimeve që nuk duhen cenuar, përfshirë dinjitetin e grave që kanë kontribuar në komedi", Këshilli sqaroi, se një gjë tillë ishte jashtë fushës dhe mundësive të veprimit të Autoritetit, të rregulluara nga dispozitat e sipërpërmendura.

Ankesa e paraqitur nga:

Subjekti audioviziv

Data

I.Rr.

Rrjeti social "Instagram"

08.08.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi me iniciale I.Rr me anë të së cilës pretendohet se "disa faqe nëpër rrjetin social Instagram të krijuara nga gjimnazistë të një gjimnazi, bullizonin dhe ofendonin nxënësit e një gjimnazi". Në lidhje me sa më sipër, sillte si shembull faqen "llafeqemoli", e hapur nga persona anonimë, ku shahen të tjerët.

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, nisi verifikimet përkundrejt pretendimeve të ankuesit lidhur me faqen "llafeqemoli", prej nga rezultoi, se në fakt kjo nuk ishte një faqe por një profil privat, i paaksesueshëm nga Autoriteti dhe për rrjedhojë, e paverifikueshme prej tij.

Në këto kushte, ankuesit iu bë me dije, se trajtimi i ankesës në fjalë dilte jashtë tagrit të Autoritetit të Mediave.

Ankesa e paraqitur nga:

Subjekti audioviziv

Data

G.

Kërkesë për informacion

19.08.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një kërkesë për informacion nga shtetasja me initiale G., bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", me pyetjet e mëposhtme:

- A ka një ligj që rregullon përdorimin e imazhit qoftë edhe për figurat historike?
- A është etike përdorimi i një reklame të tillë, kur personazhet në fjalë nuk janë gjallë për të dhënë aprovimin apo kundërshtimin e tyre?

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të kërkesës për informacion, qytetarja u informua si më poshtë vijon :

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar (me ligjin nr. 22/20162, datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017, nr. 30/2023, datë 13.4.2023), si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio/audiovizive. Nëse nga shqyrtimi i materialeve audio dhe audiovizive evidentohen shkelje, vijohet menjëherë me marrjen e masave administrative, deri në caktimin e sanksioneve përkatëse.

Për rrjedhojë, rregullimi ligjor i përdorimit të këtyre imazheve të figurave historike si dhe etika mbeten jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:

Subjekti audioviziv

Data

B.Gj/ Birn Albania

Kërkesë për informacion

26.08.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një kërkesë për informacion nga gazetarja e Birn Albania, B.Gj. lidhur me dy publikime, me përmbajtje dhune dhe denigrimi (një video e xhiruar nga polici G. që plagosi kolegun e gruas dhe një tjetër që lidhej me dhunimin e një vajze nga dy të tjera), si më poshtë :

- *A ka marrë Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ankesa nga qytetarët për këto raste?*
- *Akenikonstatuar gjatë monitorimit këto raste apo raste të ngjashme dhe a keni marrë masa ndaj tyre?*

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave u përgjigj si më poshtë vijon :

1. Pranë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s nuk kanë mbërritur ankesa lidhur me rastet e referuara.
2. Sa i takon rastit të pasqyrimin

nga subjektet audiovizive të përplasjes së dhunshme mes dy motrave dhe një vajze tjetër, në një nga lokalet e kryqytetit (<https://top-channel.tv/2024/08/26/pamjet-e-rendaO-te-fshehuOra-pas-kapeleve-momenti-kur-motrat-berishadhunojne-klea-prengen-edhe-pasi-klientet-i-ndajne-antonelamerr-tavllen-dhe-45/>), AMA, gjatë monitorimit, ka identifikuar mosrespektim të kërkesave ligjore nga dy OSHMA-ve, ndaj të cilat ka aplikuar sanksionin me gjobë, bazuar në nenin 133, pika 1/a, të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

Shkaku ishte se subjektet, gjatë transmetimit të kronikës, kanë afruar pamjet e rënda gjatë përleshjes mes palëve, duke qartësuar më shumë aktet e dhunës, goditjet dhe dëmtimet prej tyre, në vend që të përdornin teknikat e mbulimit. Edhe koha e transmetimit të këtyre përmbajtjeve ishte e papërshtatshme, kur mendohet se para ekranit janë dhe fëmijët.

Në ligjin 97/2013, neni 32/1, saktësohet se "Programet audio dhe audiovizive të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, do të transmetohen vetëm në atë mënyrë që siguron se fëmijët normalisht nuk do t'i dëgjojnë ose shohin ato, përmes zgjedhjes së kohës së transmetimit, aplikimit të mjeteve të verifikimit të moshës ose përmes masave të tjera teknike. OSHMA-të marrin masa mbrojtëse në proporcion me efektet që këto programe kanë në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve". Në nenin 33, ku flitet për detyrimet e OSHMA-ve, thuhet se ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", pika 1/"ç" Në Kodin e Transmetimit, seksioni 3, përcaktohet dhe se: "OSHMA-të, në programet informative, nuk

promovojnë për qëllime sensacionale, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhunën", pika 3.9.

Po ashtu, gjatë shqyrtimit të mbulimit nga subjektet audiovizive të këtij rasti, AMA u ka adresuar tërheqjeve mendjeje, 5 OSHMA-ve të tjera, sepse nuk kanë përdorur teknika mbulimi për pamjet e dhunshme. Megjithëse kishte distancë nga vendi ku ndodhi konflikti dhe nuk dalloheshin pasojat nga goditjet, koha e transmetimit të këtyre përmbajtjeve ishte e papërshtatshme, pasi dihej që para ekranit janë dhe fëmijët.

Përkitazi rastit të dytë, të referuar prej ankueses (<https://top-channel.tv/video/top-channel-e-filmoi-pas-plumbave-video-kur-polici-goxhara-regjistroi-lorenc-kosten-pasi-e-qelloi/>), AMA, gjatë monitorimit, konstatoi, se subjektet audiovizive në monitorim, kishin përdorur teknikën e mbulimi.

Ankesa e paraqitur nga:

G.K

Subjekti

Google

Data

02.09.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë, përmes së cilës shtetasi G.K kërkonte fshirjen nga "motorët e kërkimit si Google, Safari, Moxilla etj., të një materiali të rremë, i cili përmbante emrin dhe mbiemrin e tij.

Ankuesi shprehte shqetësimin se gjate kërkimit në internet me të dhënat "G.K" shfaqeshin materiale te cilat nuk kishin të bënin me identitetin e tij.

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës/

kërkesës dhe duke vlerësuar dhe mirëkuptuar maksimalisht shqetësimin e ankuesit, Këshilli i Ankesave e informoi, se ligji nr.97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2, "Fusha e zbatimit", (ndryshuar me ligjin nr.30/2023, datë 13.4.2023), përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove...".

Portali i listuar prej ankuesit, si edhe motori i kërkimit Google, Safari, Moxilla, ishin jashtë fushës së veprimit dhe kompetencave ligjore të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:

Data

Vizion Plus

Kërkesë për informacion

02.09.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave mori një kërkesë për informacion nga operatori Vizion Plus, lidhur me raportimin e përmbajtjeve të dëmshme, të publikuara në TikTok.

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e dhënies së informacion të kërkuar, operatori Vizion Plus u informua se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka nënshkruar marrëveshje me TikTok. Si nga përfaqësuesit e Autoritetit ashtu edhe në faqen dhe llogaritë e Autoritetit bëhet fjalë jo për marrëveshje, por për marrëdhënie bashkëpunimi, bazuar në funksionet rregullatore të AMA-s, sipas ligjit 97/2013 i ndryshuar dhe vullnetin e TikTok në dobi të ruajtjes së standardeve etike të postimeve të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme.

Më tej, Këshilli Ankesave sqaroi gjithashtu, se :

Marrëdhënia e bashkëpunimit bazohet në dispozitat e Ligjit 97/2013, "Për

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar:

- Neni 2, "Fusha e zbatimit", sipas të cilit *"Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove."*
- Neni 3, "Përkufizime", Pika 17/1, ku sqarohet, se: *"Shërbimi i platformës së shpërndarjes së videove" nënkupton një shërbim, qëllimi kryesor i të cilit ose i një pjese të shkëputur të tij, apo një funksion thelbësor i shërbimit është ofrimi për publikun e gjerë të programeve, videove të krijuara nga përdoruesi ose të dyjave së bashku, me qëllim informimin, argëtimin ose edukimin nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike për të cilat ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove nuk ka përgjegjësi editoriale, dhe organizimi i të cilës, përfshirë përdorimin e mjeteve automatike ose algoritmet në veçanti për shfaqjen, etiketimin dhe renditjen, përcaktohet nga vetë ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove."*

- Neni 3, "Përkufizime", Pika 52/1, ku sqarohet, se: *"Video e krijuar nga përdoruesi" është një grup imazhesh lëvizëse me ose pa zë, që përbëjnë një element individual, pavarësisht nga gjatësia e tij, që krijohet nga një përdorues dhe ngarkohet në një platformë për shpërndarjen e videove nga ai përdorues ose çdo përdorues tjetër."*
 - Neni 19 "Funkcionet e AMA-s", Pika 2/ë, ku sqarohet, se: *"AMA, përveç funksioneve të mësipërme: promovon dhe nxit ndërgjegjësimin publik, kërkimin dhe veprimtaritë lidhur me edukimin mediatik, përfshirë ndërgjegjësimin publik për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove."*
 - Neni 32 "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove", Pika 4, ku sqarohet, se: *"Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nuk transmetojnë programe me përmbajtje që: a) nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtarë të një grupi mbi baza të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinioni politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, mosha apo orientimi seksual, si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; b) nxisin kryerjen e veprave terroriste."*
 - Neni 32/1, Pika 4, ku sqarohet, se: *"Pa cenuar parashikimet e neneve 15 deri 20 të ligjit "Për tregtinë elektronike", ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove marrin masat e nevojshme për: a) mbrojtjen e fëmijëve nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre mendor, fizik ose moral; b) mbrojtjen e publikut të gjerë nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare audiovizive me përmbajtje që nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose anëtarësh të një grupi; c) mbrojtjen e publikut të gjerë nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare audiovizive me përmbajtje, shpërndarja e të cilave përbën një aktivitet që është vepër penale sipas legjislacionit në fuqi, apo provokim për të kryer një vepër terroriste, përbën vepër penale në lidhje me pornografinë për fëmijë, racizmin apo ksenofobinë."*
1. Bordi i AMA-s nuk ka vendimmarrje përkitazi bashkëpunimit të përmendur më lart, pasi – siç u theksua më lart – në këtë rast nuk bëhet fjalë për marrëveshje, por thjesht për një bashkëpunim, bazuar në dispozitat

ligjore të sipërpërmendura.

Në bashkëpunimet dhe marrëdhëniet me të tretët, AMA përfaqësohet nga Kryetari, bazuar në Ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

Neni 14 "Kompetencat e Kryetarit të AMA-s",

- Pika 1, sipas së cilës "**Kryetari është drejtues i AMA-s dhe ka përgjegjësi, sipas përcaktimeve të nenit 8 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"**

- Pika 2/c, së cilës "**Kryetari ushtron këto detyra kryesore: c) përfaqëson AMA-n në marrëdhëniet me të tretët dhe me organizatat ndërkombëtare"**

2. Kodi i Transmetimit për Mediat Audiovizive, me plotësimet përkitazi Platformave të Shpërndarjes së Videove, përputhur me ndryshimet e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, në rubrikën "Këshillimi publik".

Ankesa e paraqitur nga:

Subjekti

Data

A.Gj.**Kërkesë për informacion****14 & 16.10.2024****1. Objekti**

Këshilli i Ankesave mori një kërkesë për informacion nga shtetasi A.Gj., në lidhje me :

- "aksesin mediatik që ka i pandehuri Sali Berisha në live në një konferencë për shtyp"
- "masat marra ndaj televizioneve apo mediave vizive apo të shkruara për të mundësuar aksesin e një të pandehuri në televizione kombëtare dhe lokale".

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e dhënies së informacion të kërkuar, i interesuari u informua si më poshtë vijon:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 22/20162, datë 10.3.2016, vendimin

e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017, nr. 30/2023, datë 13.4.2023, si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive.

Bazuar në këtë ligj, "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë", neni 4, pika1/a). Në vijim të këtij pike, është gjithashtu edhe dispozita ku theksohet se "Vendim editorial" është vendimi që merret rregullisht për të ushtruar përgjegjësinë editoriale sipas përcaktimeve të këtij ligji për funksionimin e përditshëm të shërbimit mediatik audioviziv". Për më tepër, një ndër objektivat e veprimtarisë së AMA-s është "të sigurojë ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias" (neni 18, pika1/b).

Sa më sipër, u bë e ditur se AMA është autoritet rregullator dhe nuk ndërhyr në politikën editoriale të operatorëve mediatikë audiovizivë për sa kohë nuk evidenton shkelje të dispozitave të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti</u>	<u>Data</u>
M.P.	Rrjeti social Facebook	29.09.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave mori një ankesë përmes së cilës pretendohet se, pa miratimin e saj, në portale, mediane dhe shkruar dhe rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram" ishin publikuar shkrime për të.

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës dhe duke vlerësuar ndjeshmërinë e ankueses lidhur me publikimet në fjalë, Këshilli i Ankesave e informoi se publikimi në mediat online, shtypin e shkruar dhe rrjetet sociale janë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksion pikërisht se: "*Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare,*

transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre."

Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në bazë të një formulari ankese i cili përcakton saktësisht subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit.

Formulari, i cili gjendet në anën e djathtë, në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive (ama.gov.al) pas plotësimit, dërgohet me e-mail në adresën elektronike: info@ama.gov.al.

Gjithashtu ankesat mund të depozitohen përmes shërbimit postar ose dorazi në zyrën e protokollit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Sa më sipër, ankueses ju kërkua të specifikonte subjektet audiovizive (mediat) ndaj të cilave drejtonte ankesën e saj!

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Znj. D.	Top Channel	Rek. e DigitAlb	03.09.2024 14/16.10.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave mori një ankesë nga znj.D. në lidhje me reklamën e fundit të "DigitAlb".

Në ankesën e saj ajo pretendonte se reklama "përforconte imazhin e gruas në Shqipëri si pronë, objekt, etj." dhe kërkonte reagim institucional.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të trajtimit të ankesës, ajo u informua se përmbajtja audiovizive, së cilës i referohej, reklama e "DigitAlb", ka qenë objekt shqyrtimi i Autoritetit të Mediave Audiovizive, i cili i ka kërkuar OSHMA-së rishikimin e raporteve të konvencionit me mesazhin promociional të reklamës.

Nga verifikimet e kryera, rezultonte se OSHMA-ja kishte reflektuar duke reduktuar spotin me fokus vetëm në promovimin e produktit.

Ankesa e paraqitur nga:

Subjekti

Data

11.10.2024

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim Tik Tok

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një kërkesë për informacion nga znj. M.R. e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim mbi marrëveshjen e bashkëpunimit mes AMA-s me Tik Tok

2. Administrimi & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përmbushje të detyrimeve që ngarkon ligji për të drejtën e informimit, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e informoi se "marrëdhënia, së cilës i referohet ankuesja, nuk është marrëveshje, por një marrëdhënie bashkëpunimi, bazuar në funksionet rregullatore të AMA-s, sipas ligjit 97/2013 i ndryshuar dhe vullnetin e Tik-Tok në dobi të ruajtjes së standardeve etike të postimeve të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme".

Në lidhje me procedurën e AMA-s, sa i takon fshirjes së përmbajtjeve të raportuara, iu bë me dije se "TikTok

nuk është platformë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Për këtë arsye, bashkëpunimi në fjalë bazohet jo vetëm në funksionet rregullatore të AMA-s, sipas ligjit 97/2013 i ndryshuar, por edhe në vullnetin e Tik-Tok në dobi të ruajtjes së standardeve etike të postimeve të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme".

Sa i takon statusit të AMA-s, "bashkëpunimi me TikTok është konkretizuar me hapjen e kanalit të posaçëm të komunikimit midis TikTok dhe AMA, më datë 22 gusht 2024, me të cilin u bë i mundur raportimi i shkeljeve dhe shqyrtimi i tyre me prioritet nga ana e TikTok. (Ndryshe, nisur nga pesha e papërfillshme e përdoruesve shqiptarë në numrin e përgjithshëm të përdoruesve globalë të platformës, përdoruesit shqiptarë dhe shqetësimet e tyre do duhej të prisnin pafundësisht)".

Për rastet kur përmbajtjet që nuk fshihen, vendimmarrja fundore i takon platformës.

Marrëdhënie e bashkëpunimit bëhet sipas ligjit 97/2013 i ndryshuar dhe vullnetin e Tik-Tok në dobi të ruajtjes së standardeve etike të postimeve

të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme, kjo lloj gatishmërie nuk është sinjalizuar nga ndonjë platformë tjetër e shpërndarjes së videove.

Marrëdhënia e bashkëpunimit midis AMA dhe TikTok me qëllimin e përbashkët, për të krijuar një mjedis sa më të shëndetshëm digjital shkon në zbatim të detyrimeve periodike të përafrimit të legjisllacionit të brendshëm me Acquis e BE-së në fushën e medias audiovizive dhe platformave të shpërndarjes së videove. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar më 25 maj 2023, ndryshime këto të cilat përafuan plotësisht Direktivën 2010/13/EU "Audiovisual Media Services Directive" (AVMSD), të amenduar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian kompetencat rregulluese të Autoritetit shtrihen edhe mbi platformat e shpërndarjes së videove – si në rastin kur ato janë nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe kur i drejtohen publikut shqiptar pavarësisht se ndodhen apo janë themeluar në një shtet tjetër.

Sa i takon DSA-së, Shqipëria është në fazat e hershme të implementimit dhe përfshirjes institucionale. Akti i Shërbimeve Digjitale është shumë komplekse dhe kërkon vëmendje administrative ndër-institucionale.

Cilat janë kriteret e AMA që përcaktojnë klasifikimin e përmbajtjeve

të raportuara? Lutemi specifikoni procedurën dhe bazën ligjore të zbatuar nga AMA për klasifikimin e një përmbajtjeje si të dëmshme; përkufizimin e përmbajtjes së dëmshme; përkufizimin e përmbajtjes së mbrojtur, përmbajtjes me interes publik etj.

Marrëdhënia e sipërpërmendur e bashkëpunimit bazohet në dispozitat e mëposhtme të Ligjit 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar:

Neni 2, "Fusha e zbatimit", sipas të cilit "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove."

Neni 3, "Përkufizime", Pika 17/1, ku sqarohet, se: "*Shërbimi i platformës së shpërndarjes së videove*" nënkupton një shërbim, qëllimi kryesor i të cilit ose i një pjese të shkëputur të tij, apo një funksion thelbësor i shërbimit është ofrimi për publikun e gjerë të programeve, videove të krijuara nga përdoruesi ose të dyjave së bashku, me qëllim informimin, argëtimin ose edukimin nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike për të cilat ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove nuk ka përgjegjësi editoriale, dhe organizimi i të cilës, përfshirë përdorimin e mjeteve automatike ose algoritmet në veçanti për shfaqjen,

etiketimin dhe renditjen, përcaktohet nga vetë ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove."

Neni 3, "Përkufizime", Pika 52/1, ku sqarohet, se: "Video e krijuar nga përdoruesi" është një grup imazhesh lëvizëse me ose pa zë, që përbëjnë një element individual, pavarësisht nga gjatësia e tij, që krijohet nga një përdorues dhe ngarkohet në një platformë për shpërndarjen e videove nga ai përdorues ose çdo përdorues tjetër".

Neni 19 "Funksionet e AMA-s", Pika 2/ë, ku sqarohet, se: "AMA, përveç funksioneve të mësipërme: promovon dhe nxit ndërgjegjësimin publik, kërkimin dhe veprimtaritë lidhur me edukimin mediatik, përfshirë ndërgjegjësimin publik për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove."

Neni 32 "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove", Pika 4, ku sqarohet, se: "Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nuk transmetojnë programe me përmbajtje që: a) nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtar të një grupi mbi baza të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinioni politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, mosha apo

orientimi seksual, si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; b) nxisin kryerjen e veprave terroriste."

Neni 32/1, Pika 4, ku sqarohet, se: "Pa cenuar parashikimet e neneve 15 deri 20 të ligjit "Për tregtinë elektronike", ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove marrin masat e nevojshme për: a) mbrojtjen e fëmijëve nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre mendor, fizik ose moral; b) mbrojtjen e publikut të gjerë nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare audiovizive me përmbajtje që nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose anëtarësh të një grupi;

c) mbrojtjen e publikut të gjerë nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare audiovizive me përmbajtje, shpërndarja e të cilave përbën një aktivitet që është vepër penale sipas legjislacionit në fuqi, apo provokim për të kryer një vepër terroriste, përbën vepër penale në lidhje me pornografinë për fëmijë, racizmin apo ksenofobinë."

Në faqen e web të AMA-s për konsultim publik ndodhej dhe «Mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme për platformat e shpërndarjes së videove » https://ama.gov.al/ova_doc/keshillim-publik/ - ku përcaktoheshin procedurat e sinjalizimit dhe raportimit

të videove sipas fushave të lejueshme dhe të ligjshme pranë platformës TikTok.

Në konkretizim të bashkëpunimit me TikTok, AMA ka proceduar me hapjen e një dritareje në faqen e saj web, ku mundësohet dërgimi i ankesave nga qytetarët. Plotësimi i formularit të aksesuar në dritaren e komunikimit vijon me procesimin e videos që kontestohet. AMA nuk kryen monitorim të platformave on line.

Strukturat e ngarkuara me verifikimin e standardeve të postimeve të raportuara, janë: Këshilli i Ankesave, Drejtoria e Legjislacionit Ndërkombëtar, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK. Autoriteti NUK monitoron, por vepron sipas ankesave apo raportimeve të publikut. Pas verifikimit nga ana e strukturave të sipërpërmendura, platforma njoftohet për postimet, që rezultojnë se përmbajnë shkelje të ligjit duke argumentuar shkeljen ligjrisht, përmes referimit të dispozitave përkatëse.

Nuk ka asnjë udhëzim të posaçëm për institucionet për të raportuar përmbajtjet e dëmshme. Ashtu si deri tani me ankesat në adresë të mediave audiovizive, institucionet sikurse individët, janë të detyruar të ndjekin të njëjtën rrugë: nëpërmjet plotësimit të formularit online.

Përtej kësaj, AMA ka marrëveshje

bashkëpunimi për adresimin e shqetësimit qytetar për rastet kur objekti i ankesës del jashtë fushës së veprimtarisë së AMA-s (si p.sh. në raste denoncimi aktesh kriminale).

Përtej faktit, që natyra e shkeljeve, që trajtohen janë të njëjtat si deri tani në mediat audiovizive, për specifikat, trajnimi i punonjësve të AMA-s për mënyrën e raportimit në kanalin e mundësuar nga TikTok është bërë nga përfaqësuesit më të lartë të Tik Tok, përputhur me Udhëzuesin e platformës dhe ligjin 97/2013 i ndryshuar. Trajnimet online vijuan me takimin e datave 10-11 tetor në Tiranë, ku përfaqësuesit më të lartë të platformës Tik Tok u takuan jo vetëm me përfaqësuesit e AMA-s, por edhe me përfaqësuesit e rregullatorëve audiovizivë të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Strukturat e ngarkuara me verifikimin e standardeve të postimeve të raportuara, janë: Këshilli i Ankesave, Drejtoria e Legjislacionit Ndërkombëtar, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK.

Autoriteti nuk monitoron, por vepron sipas ankesave apo raportimeve të publikut.

AMA raporton pranë TikTok vetëm ankesat e publikut të postimeve të përdoruesve individualë, të cilët nuk mbajnë përgjegjësi editoriale. Shpjegime të mëtejshme për rastet, që nuk trajtohen nga Autoriteti

edhe nëse për to ka ankesa, gjeni në Rregulloren e Autoritetit «Mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme për platformat e shpërndarjes së videove » [https://ama.gov.al/ova_doc/keshillim-publik/-](https://ama.gov.al/ova_doc/keshillim-publik/)

Në Shqipëri nuk janë regjistruar platforma të shpërndarjes së videove.

Në aktin nënligjor («*Mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme për platformat e shpërndarjes së videove* ») që AMA ka publikuar ne faqen zyrtare te internetit, është parashikuar shprehimisht dhe mbrojtja e të dhënave personale në çdo rast për të gjithë personat të cilët sinjalizojnë Autoritetin për postimet e dëmshme në platformen Tik Tok. Mbrojtja e Të Dhënave Personale bëhet sipas parashikimeve të Ligjit 9887/2013, i ndryshuar. Në asnjë rast këto të dhëna nuk shfrytëzohen me qëllime të tjera, por vetëm për administrimin e ankesës

së paraqitur nga qytetari si dhe vlerësimin e ankesës në kthim përgjigje. Në çdo rast videot e raportuara pranë platformës ruhen për një periudhë 3 mujore.

Procedura e procesimit të ankesës përfundon me raportimin pranë platformës. Kjo e fundit, pasi proceson raportimin, vendos për heqjen ose jo të videos sipas Udhëzuesit të funksionimit të vetë platformës.

Si përfundim: AMA raporton pranë TikTok vetëm ankesat e publikut përkitazi postimeve të përdoruesve individualë, të cilët nuk mbajnë përgjegjësi editoriale. Shpjegime të mëtejshme për rastet, që nuk trajtohen nga Autoriteti edhe nëse për to ka ankesa, gjeninë Rregulloren e Autoritetit "Mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme për platformat e shpërndarjes së videove" [https://ama.gov.al/ova_doc/keshillim-publik/-](https://ama.gov.al/ova_doc/keshillim-publik/).

Ankesa e paraqitur nga:

L.Gj.

Data

- **12.10.2024**

1. Objekti i Ankesës

Ankuesja, L.GJ kërkoi prej Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) marrjen e masave ndaj një OSHMA-je, me pretendimin se gjatë një debati televiziv, deklaratat e saj ishin nxjerrë jashtë kontekstit, duke krijuar keqkuptime në dëm të saj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankueses plotësimin e të dhënave në kuadër të administrimit të saj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Bordi i AMA-s	Top Channel	E diell	11.11.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga Bordi i Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) në lidhje me një intervistë të A.M. zhvilluar në emisionin "E Diell", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 03.11.2024.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës Këshilli i Ankesave i kërkoi nga Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Top Channel", paraqitje pretendimesh.

Në përgjigjen e vet OSHMA-ja, bëri me dije se: *"A.M në asnjë moment nuk u shpreh me fjalë ku të glorifikonte figurën e ish -diktatorit Enver Hoxha. E njëjta qasje është dhe për moderatorin E.M, i cili në asnjë moment nuk lartësoi dhe glorifikoi figurën e ish -diktatorit"*.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, rubrika "Galeri" e emisionit "E Diell", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 03.11.2024 ora

16:50, Këshilli i Ankesave evidentoi se:

- *Gjatë intervistës të zhvilluar me A.M, tregon edhe një pjesë të jetës së tij, si djali i një ish -funksionari të lartë të shtetit në kohën e komunizmit. Intervista shoqërohet me foto të familjes me ish -diktatorin Enver Hoxha.*
- *Përkundrejt, pretendimeve të OSHMA-së: "Nuk duhet ngatërruar qasja dashamirëse e moderatorit me të ftuarit gjatë emisionit", u konstatua, se moderatori shprehu simpati: "Ah sa foto e bukur!", dhe në momente të tjera nuk u tregua objektiv dhe i paanshëm.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive si dhe nga kthim përgjigjja e OSHMA-së, u evidentua se kishte shmangie nga ligji nr.97/2013 dhe Kodi i Transmetimit, për rrjedhojë, trajtimi nuk siguronte informim objektiv dhe të paanshëm, të plotë, të padiferencuar dhe të pandikuar ideologjikisht e politikisht. Trajtimi nuk ishte i drejtë për të gjitha subjektet

e interesuara dhe nuk iu shërbente nevojave demokratike të shoqërisë, por madje lëndonte, shqetësonte seriozisht një numër të konsiderueshëm shikuesish, të përndjekur ose prekur direkt apo indirekt nga diktatura si edhe ndikonte negativisht në edukimin e brezit të ri, një pjesë e konsiderueshme

e informacionit të të cilit për atë periudhë buron ende nga media. Ndaj Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së, për shmangie prej Ligjit nr.97/2013 *"Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit.